



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislacioni IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme

Mbledhja nr. 64

Prishtinë, më 1 tetor 2013, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala C-301

P r o c e s v e r b a l

Nga takimi i përbashkët me Komisionin për Integritet Evropian dhe deputetët e Këshillit Kombëtar të Sllovakisë.

Në takim mori pjesë delegacioni i deputetëve të Këshillit Kombëtarë të Sllovakisë në përbërje: z. Ivan Stefanec, z. Mikulas Huba, z. Antonin Cicon, z. Jozef Miklosko, z. Ivan Svejna, z. Miroslav Kaduc, z. Juraj Droba, z. Jozef Viskupic dhe stafi mbështetës z. Pavol Strba, z. Marek Travnicek, znj. Lucia Klapacova dhe znj. Eliska Slavikova.

Në takim nga anëtarët e Komisionit për Punë të Jashtme morën pjesë: z. Albin Kurti, z. Enis Kervan, z. Sabri Hamiti, znj. Emilija Rexhepi dhe z. Hamza Balje.

Nga anëtarët e Komisionit për Integritet Evropian morën pjesë: z. Xhavit Haliti, znj. Alma Lama, z. Blerim Shala, znj. Suzana Novobrdali, znj. Blerta Deliu-Kodra dhe z. Albert Kinolli.

Stafi mbështetës i komisioneve: Minire Hasani, Ahtere Loxha dhe Safet Beqiri.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d d i t e:

Takimi i përbashkët me Komisionin për Integritet Evropian dhe deputetët e Këshillit Kombëtar të Sllovakisë;

Albin Kurti, delegacionit i dëshiroi mirëseardhje në Kosovë dhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në këtë takim të përbashkët, me anëtarët e Komisionit për Punë të Jashtme dhe të Komisionit për Integritet Evropian. Që nga shpallja e pavarësisë e deri më tash, ai tha se Kosovën e kanë njohur më shumë se gjysma e shteteve anëtare të OKB-së dhe 23 vende të BE-së. Kosova vazhdon të inkurajojë dhe kultivojë marrëdhënie të mira me të gjitha vendet në forumet e ndryshme ndërkombëtare dhe është e gatshme për marrëdhënie të mira bilaterale me të gjitha vendet e BE-së, duke përfshirë këtu edhe pesë vendet që ende nuk e kanë njohur Kosovën. Përkundër faktit që

Sllovakia nuk e ka njohur Kosovën, Kurti tha se jemi të interesuar të kemi marrëdhënie të mira në mes të Kosovës e Sllovakisë, në rrafshin politik, institucional, e po ashtu edhe në atë kulturor e ekonomik, në mënyrë që sa më parë të presim dhe të kemi njohjen e Kosovës nga Sllovakia. Ndër sfidat e shtetformimit të Kosovës, ai i theksoi vështirësitë që është duke i shkaktuar Serbia përmes strukturave të saj ilegale, armiqësore e kriminale dhe sfidën e zhvillimit ekonomik, që reflekton me një varfëri, papunësi e korrupsion. Kurti po ashtu e njoftoi delegacionin për vuajtjet e popullit shqiptar edhe gjatë kohës së ish- Jugosllavisë, para luftës, gjatë së cilës kohë, shqiptarët kishin standard të ulët të jetesës e numër të madh të burgosurve, gjatë luftës për numrin e të vrarëve, të zhdukurve, dëmet e luftës dhe pas luftës për vuajtjet e obstruksionet e Serbisë, të cilat tha se nuk po ndalen. Kurti theksoi se jemi të interesuar të integrohemi në BE, mirëpo rruga e BE-së për Kosovën duhet të jetë rrugë direkte, e Prishtinës me Brukselin, e jo rrugë që kalon përmes Beogradit.

Ivan Stefanec, falënderoi deputetët për mikpritjen në këtë takim të përbashkët dhe prezantoi përbërjen e delegacionit të Sllovakisë. Ai theksoi se, edhe pse Sllovakia nuk e ka njohur pavarësinë e Kosovës, marrëdhëniet në mes të parlamenteve janë të rëndësishme dhe mund të përmirësojnë marrëdhëniet në mes të dy vendeve. Stefanec njoftoi për procesin e integrimit dhe anëtarësimit të Sllovakisë në BE, dhe se e mbështesin integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE. Ai kërkoi të informohet për zhvillimin ekonomik të Kosovës në të ardhmen, se në cilat fusha të industrisë mund të ketë zhvillim dhe se cili është komunikimi me Beogradin tani, dhe si shihet ai në të ardhmen.

Jozef Miklosko, ndër të tjera shtroi çështjen e nxjerrjes dhe ndryshimit të ligjeve, duke cekur se ato duhet të jenë në frymën demokratike. Miklosko theksoi se ndër prioritet e Kosovës është struktura e popullsisë e përbërë me shumicë nga brezi i ri, për të cilët duhet gjetur mundësinë, që të mos shkojnë nga vendi. Ai po ashtu u interesua për liritë fetare, për integrimin e komuniteteve pakicë, sidomos për të zhvendosurit serbë, për të cilët tha se 200 mijë serbë janë zhvendosur nga Kosova, nga të cilët 40 mijë nga Prishtina, si dhe për rezultatet e kthimit të tyre.

Xhavit Haliti, duke e falënderuar delegacionin nga Sllovakia, theksoi rëndësinë e këtij takimi, pasi që Sllovakia është një ndër pesë shtetet anëtare të BE-së që ende nuk e ka njohur pavarësinë e Republikës së Kosovës. Ai tha se jemi dy vende mike, të cilat komunikojmë edhe përmes institucioneve edhe përmes lëvizjes së qytetarëve dhe se kjo situatë ndikon pozitivisht në të ardhmen tonë.

Haliti njoftoi se si komisione, jemi në përbërje shumë nacionale dhe shumë partiake dhe se kemi një mesazh për delegacionin që të ndikojnë tek politikat e Sllovakisë që, sa më shpejt, të njihet Republika e Kosovës. Jugosllavinë, theksoi Haliti se e kanë shpërbërë serbët, kroatët dhe sllovenët, ndërsa shqiptarët kanë qenë të pushtuar dhe të shtypur. Dëshira jonë dhe përpjekjet tona janë që raportet të ç'tensionohen në Ballkan. Ai njoftoi se bisedimet në mes të Serbisë dhe Kosovës janë duke u zhvilluar dhe janë nënshkruar disa marrëveshje shumë të vlefshme, për të ç'tensionuar raportet në mes të dy vendeve.

Sa i përket largimit të serbëve, tha se është e vërtetë që serbët u larguan, por, ne nuk i kemi larguar, ata ikën vet, duke shtuar se serbëve ju kemi ndërtuar shtëpi në Kosovë, mirëpo, ata e kanë të vështirë të kthehen tani sepse janë integruar në Serbi dhe shumica e kanë shitur pasurinë të cilën e kanë pasur në Kosovë. Haliti shtoi, se ata i kanë vendet e rezervuara në Parlamentin e Kosovës dhe kjo krijon një favor të madh për tu integruar në politikën e Kosovës.

Haliti theksoi se Parlamenti i Kosovës është i interesuar që të ndërtojë një bashkëpunim të mirëfilltë me sllovakët, ndërsa shtoi se edhe bizneset sllovake, janë të mirëseardhura në Kosovë.

Vjosa Osmani, shprehi kënaqësinë, që bashkëpunimi në mes të dy vendeve është duke u intensifikuar. Sa i përket legjislacionit, ajo theksoi se që nga viti 1999, të gjitha ligjet e kohës komuniste u zëvendësuan me rregulloren e UNMIK-ut dhe para pavarësisë ato u zëvendësuan me ligjet e Kosovës, të cilat janë në harmoni me standardet evropiane. Ne e kemi Ligjin për të drejtat fetare, i cili i jep më shumë të drejta kishës ortodokse serbe se sa çdo komuniteti tjetër.

Osmani theksoi se jemi të interesuar ta ruajmë trashëgiminë kulturore të çdo komuniteti.

Ajo falënderoi sllovakët për rolin, të cilin ata e luajtën në intensifikimin dhe përmirësimin e lidhjeve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Më tej, pyeti se si parlamenti do të mund të kishte një rol më të fortë që të kontribuoj më shumë në integrimin evropian .

Sabri Hamiti, i njoftoi të pranishmit se ka njohuri për historinë dhe kulturën e Çekosllovakisë dhe të Sllovakisë. Duke iu referuar të dhënave nga delegacioni sllovak, lidhur me numrin e serbëve të shpërngulur , Hamiti tha se nuk ka fakte për ato të dhëna dhe se janë fjalë që qarkullojnë. Më tej shtoi se në Kosovë, nuk kanë jetuar kurrë 200.000 serbë, sipas regjistrimit të popullsisë të bërë nga vetë shteti i Serbisë në Kosovë. Kanë jetuar afërsisht 190.000 serbë, ndërsa sot në Kosovë jetojnë mbi 100.000 serbë, në Prishtinë asnjëherë nuk kanë jetuar 40.000 serbë dhe se kjo shifër është e hamendësuar.

E pohoi atë që tha z. Haliti për shpërnguljet, por shtoi se duhet të këtë kujdes, nëse llogaritet soldateska serbe e viteve të '90, ku janë sjell 100.000 njerëz këtu, atëherë ky numër mund të rritet, ngase ata nuk kanë jetuar këtu, kanë ardhur për të bërë terror, forca paramilitare, militare, e ushtarake, të cilat kur e kanë humbur luftën janë larguar.

Lidhur me komunën e Prishtinës, Hamiti tha se më parë Graçanica ka qenë brenda territorit të Prishtinës, sot Graçanica është komunë serbe dhe qeveriset nga serbët. Në Kosovë nuk diskriminohen fetë, porse gabimi qëndron në mendimin se duke favorizuar fe, krijohet barazia, ky është edhe problemi me ortodoksizmin. Askush nuk merret me ortodoksizmin si fe, por kur bëhet instrument politik, atëherë po, kështu që duke kërkuar status special për kishën ortodokse, në një vend ku dominojnë myslimanët, ku ekziston edhe kisha katolike, vetvetiu politika bëhet ngatërrestare në fe.

Suzan Novobrdaliu, duke iu referuar pyetjes se pse nuk kishte përfaqësues të kombësisë serbe, ajo njoftoi se ata mungojnë për arsye të tyre, ata janë të ftuar në mbledhje, njëri nga ta është nënkryetar i Komisionit për Integritet Evropian, ndërsa tjetri është Nënkryetar i Kuvendit. Sa i përket infrastrukturës ligjore për të drejtat e njeriut, Novobrdaliu tha se Kosova ka miratuar një sërë ligjesh, sa i përket të drejtave të njeriut, duke shtuar se edhe me Kushtetutë janë të garantuara të drejtat e njeriut. Po ashtu tha se janë miratuar tetë (8) Konventa si dhe ligje të tjera që garantojnë liritë dhe të drejtat e njeriut.

Alma Lama, i uroi mirëseardhje delegacionit, duke u ndërlidhur me pyetjen se cilat janë marrëdhëniet me Serbinë dhe për fenë, duke shtuar se janë të angazhuar që fenë ta mbajnë jashtë politikës. Lidhur me marrëdhëniet me Serbinë, ajo tha se problem është pjesa veriore e Kosovës ngase Beogradi luan një rol destruktiv atje. Edhe pse po zhvillohen biseda dhe se Beogradi thotë që ka interes për t'i zgjidhur çështjet, faktet në terren tregojnë që ata nuk janë të interesuar dhe se duhet t'i bëhet presion Beogradit që ta zgjidh këtë çështje. Ajo tha se Kosova e ka treguar gatishmërinë që të zgjidh problemet me Serbinë, ka bërë shumë koncesione, i janë dhënë shumë të drejta minoriteteve, të cilat as ju nuk i keni në shtetin e juaj. Kushtetuta e Kosovës është më e avancuara në botë për trajtimin e minoriteteve, problemi qëndron tek dëshira e Beogradit për t'i zgjidhur këto çështje.

Emilija Rexhepi, i uroi mirëseardhje delegacionit duke i njoftuar se vjen nga komuniteti boshnjak dhe se përpos komunitetit serb në Kosovë jetojnë edhe komunitetet tjera, siç janë ai boshnjak, turk, rom dhe janë pjesë e integruese e shoqërisë kosovare. Kosova tha se është një shtet i ri, duke i krijuar proceset e veta demokratike, ku përvoja edhe profesionalizmi i juaj është i mirëseardhur për ne.

Enis Kervan, i njoftoi të pranishmit së komunitetet pakicë jo serbe janë në numër më të madh se sa komuniteti serb që jeton në Kosovë. Shpesh ndodh të ketë ankesa se komuniteti serb është më i favorizuar nga institucionet apo nga shtetet mike se sa komunitetet e tjera.

Ai shtoi se nga grupi parlamentar i serbëve, kemi përfaqësues në komisionet parlamentare dhe se serbët të cilët e kanë pranuar realitetin dhe demokracinë në Kosovë e kanë besimin e plotë në institucionet parlamentare. Me tej, ai i ceku disa institucione të rëndësishme të Republikës së Kosovës, të cilat udhëhiqen nga komuniteti serb. Në parlament tha se ekziston Komisioni për Komunitete dhe kryetari është serb, në kuadër të Zyrës së Presidentes së Kosovës ekziston Këshilli Konsultativ për Komunitete, kryetari është serb, në kuadër të Kryeministrit të Kosovës ekziston Komisioni për Komunitete, ku kryetari është serb, në Parlament ekziston nënkryetari i përhershëm për komunitete dhe është serb. Në çdo komunë ekzistojnë komisionet për komunitete dhe shumica e kryetareve të këtyre komisioneve janë nga komuniteti serb.

Jozef Viskupic, tha se është i njohur me çështjet e minoriteteve dhe të fesë. Ajo çfarë është e rëndësishme, është të njihem me njeri tjetrin. Me tej shtoi se të dy shtetet kanë ngjashmëri dhe se shumë procese në pikëpamje të përgjithshme janë të dhimbshme, andaj edhe duhet të ndihmojmë njëri-tjetrin duke i ndarë përvojat dhe kjo mund të arrihet me anë të një grupi të miqësisë jo formal. Ky është një moment historik për mua edhe për vendet tona, sepse kemi spektër të gjerë politik këtu. Dëgjuam opinionet tuaja dhe mendoj se do jetë jo vetëm një hap por edhe një hov i rëndësishëm në përmirësimin e marrëdhënieve.

Ivan Stefanec, në pyetjen se si të përmirësohet roli i Parlamentit, tha se është e rëndësishme që të keni ligje në harmoni me *acquis communautaire*. Parlamenti duhet të ketë më shumë kompetenca se qeveria. Në Sllovaki, parlamenti mund të ndryshojë pozicionin e qeverisë në çdo çështje evropiane. Përkrah idenë e formimit të grupit jo formal të miqësisë për të intensifikuar kontaktet në mes parlamentarëve.

Sa i përket liberalizimit të vizave, Stefanec tha se është një proces i rëndësishëm, sidomos për të rinjtë. Ai tha se arsyeja pse janë në Kosovë, është se duan të njihen drejtpërdrejt me situatën dhe gjendjen sepse mesazhet të cilat i marrin për Kosovën, janë të ndryshme.

Albin Kurti, i falënderoi të pranishmit për këtë diskutim të hapur dhe të sinqertë me shpresë që ky komunikim do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Takimi përfundoi në orën 11:06.

Kryetari i Komisionit

Albin Kurti

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.